



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr 2231 Prot

Tiranë, më 23.02.2024

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, Statutit të miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e TKOBAP-së”, shpall audicionin për korin e “Zërave të Bardhë”, për fëmijët nga mosha 8-11 vjeç, i cili do të mbahet më 26.03.2024, ora 16:30 në Hollin Koncertor të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor.

Fëmijët pjesëmarrës do të performojnë nëpërmjet një materiali si: këngë ose romancë të zgjedhur nga ata vetë dhe gjatë performancës do të testohen për veshin melodik, ritmik dhe për aftësitë e tyre vokale.

Për të dërguar të dhënat e fëmijës tuaj (emër, mbiemër, mosha, shkolla, pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme, instrumentin që **mund** të luajnë dhe një numër kontakti të prindërve) deri më 19.03.2024 dhe për çdo paqartësi mund të na kontaktoni në e-mail-in zyrtar të TKOBAP: sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshtina

